



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 94/13
Prishtinë, më 19.06.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jellena Bontić Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri, Sevdije Lama, Hykmete Bajrami dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku, Albulenë Gashi, Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm, Besim Beqaj, Ministër i Financave, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidentes.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012;
3. Shqyrtimi Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti me raportin plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
5. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2013;
6. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2014/01;
7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja theksoi se rendi i ditës ka ndryshime pika 3,5,7 shtyhen për mbledhjen e radhës.

Rendi i ditës u miratua njëzëri me ndryshime. Hiqen nga rendi i ditës pika 3,4 dhe 7 dhe në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012;

Latif Gashi konsideroj se është një raport i mirë teknik, ka avancime në shpenzime në të gjitha kategoritë megjithatë është e nevojshme të marrim disa përgjigje posaçërisht tek tabela 4c). që ka të bëjë me shpenzimet për *Mallra dhe Shërbime*, për shpenzimet brenda vendit që janë shpenzuar më shumë sesa ato të planifikuara. Poashtu në pozicionin e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, mëditjet e udhëtimit zyrtar, qiraja për pajisjet e planifikuara, kemi tejkallime.

Kryetarja kërkoj sqarim lidhur me pagat e personelit pasi që në raport nuk ka shënime.

Lars Lage Olofsson sqaroi se udhëtimet brenda vendit për vitin 2011 kanë qenë të planifikuara 500 kurse për vitin 2012 ishte 1000, kjo është reflektim i faktit se kemi filluar të bëjmë auditimin e shumë komunave, nga 32 komunat që i kontraktim nëpër firma private kemi arritur në 11, tani jemi me një staf më të avancuar. Kjo ka dërguar në një reduktim të kostos për sa i përket *Mallrave dhe Shërbimeve*, kosto për stafin dhe udhëtimet brenda vendit rriten. E njëjta vlen edhe për Mëditjet të cilat rriten për stafin tonë, dhe në këtë rast është e vështirë të planifikohet sepse varet nga ditët që jemi jashtë duke audituar. Pra, gjatë vitit planifikojmë që të bëhet më shumë punë audituese në terren. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë rritur për shkak të auditimit përmes mostrimit statistikor, një numër më të lartë të ambasadave jashtë shtetit, kështu që numri i auditimeve ka arritur në katër, por nëse shikohet dhe krahasohet me koston totale për sa i përket këshilltarëve të jashtëm, kursimi që kemi bërë janë më të larta sesa që kanë kushtuar. Kostot kanë zbritur nga 145,000 në 91,000, pra në përgjithësi kemi kursyer para, pastaj kemi edhe qiraja për pajisje të fotokopjeve, siç është planifikuar 14000 por kosto reale është më e lartë sepse po hartojmë shumë raporte saktësisht 115 raporte. Sa i përket pyetjes për pagat e personelit, kjo është çështje e hapur sesa fitojnë ata, por arsyeja pse nuk e keni informacionin sepse stafi jonë nuk mund të ndahet në kategori që ju i keni në këtë tabelë, por që duhet ti kategorizoni ashtu siç janë.

Naser Osmani pyetja ka të bëjë me tejkallim të shpenzimeve kurse arsyetimi juaj është se keni punuar më shumë keni shpenzuar më shumë. Nuk ka të bëjë me kurse sepse nuk jeni agjencion i kurseve. Pra, keni të drejtë të shpenzoni aq sa i keni të lejuara, asnjë tejkallim tjetër nuk lejohet më së paku nga ZAP.

Latif Gashi sqaroi se kemi të bëjmë me një institucion të monitorimit dhe shpenzimit të buxhetit, nuk besoj se duhet të përsëriten këto gabime ngase do të bëhet një planifikim paraprak poashtu për rrymë në vitin 2011 keni pas të planifikuara 17,000 të realizuara 16,361. Pyetja është se çka ka ndodhur me planifikimin 15,000 kurse i keni shpenzuar 19,246 apo shprehur në përqindje 128% tejkallim i buxhetit 28% ?

Lars Lage Olofsson sqaroi se nuk kam pikëpamje se zyra ime ka tejkalluar buxhetin në çdo kategori, pasi që i kemi kategoritë e qarta, në rastet kur është dashur të kalojmë nëpër kategori e kemi bërë në mënyrën që është dashur duke u konsultuar me Ministrinë e Financave. Ndërsa sa i përket nga ana e brendshme në kategorinë buxhetore planifikon diçka por gjërat nuk shkojnë ashtu siç e planifikon. Çmimet rriten dhe sa i përket shërbimeve komunale nuk është që shpenzuesi buxhetor i planifikon vet, janë të planifikuara nga

stafi. Nuk bëhet nga organizatat buxhetore, nuk është diçka që komandohet. Nuk mendoj se nëse zbërthen çdo kategori në mënyrën sesi përcaktohet në MF, asgjë nuk do të shkoj në kufirin të cilin e cakton.

Naser Osmani kërkoj sqarim në pozicionet të aprovuara dhe të shndërruara keni tejkalim.

Latif Gashi shqetësimi jonë është ngase udhëhiqni një institucion që duhet të monitoroj gjithë shpenzimet e buxhetit, a keni tolerancë edhe për organizatat e tjera buxhetore nëse i bëjnë këto tejkalime, pasi që ky keq planifikim duke u shërbyer me raportin e juaj për vitin 2011 keni planifikuar 17,000€ rrymë kurse për vitin 2012 keni planifikuar 15,000€ kurse keni shpenzuar 19,246 €. Mendoj se ky është një keqmenaxhimi. Qëndron fakti se një organizatë buxhetore duhet të shpenzoj aq sa ka planifikuar.

Sali Asllanaj si Komision mos të mbështetemi në gçikërrime për disa gjëra të vogëla që janë bërë, tejkalime prej një kategorie në të tjetrën dhe kjo është objekt shqyrtimi në komisioni për mbikëqyrjen e financave publike. Është vështirë planifikimet të realizohen qindpërqind dhe kjo po ndodh edhe me organizatat tjera. Raporti po duket voluminoz dhe më i detalizuar se herave tjera.

Kryetarja ajo që do të doja që zyra e auditorit gjeneral të na dërgojë shënime që mungojnë për të punësuarit edhe për mënyrën e shpenzimit të mjeteve sipas formularit, që iu kemi kërkuar të gjitha institucioneve. Pra të sqarohen dallimet e përqindjes për mallra dhe shërbime në dy tabelat dhe të dhënat për punëtorët, pagat dhe shtesat eventuale që marrin.

Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Hykmete Bajrami dhe Duda Balje, një Kundër (Sali Asllanaj), dhe dy Abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) nxorri këtë

Përfundim

Shtyhet shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për një takim tjetër të komisionit. Kërkohet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të informata shtesë lidhur me shpenzimet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime si dhe të dhëna të detalizuara për numrin total të të punësuarve, pozitat e plotësuar, nivelin e pagave dhe koeficientëve sipas pozicioneve të stafit dhe shtesave eventuale të tyre.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti me raportin plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetarja thekson se e kemi shqyrtuar projektligjin dhe raportin e komisionit funksional dhe i kemi propozuar disa plotësime dhe ndryshime, në takimin të cilin e kemi pas dhe kanë qenë të pranishëm zv ministri Avdiu edhe ministri i punës e mirëqenies sociale z.Rashiq. Po ashtu i kemi pas disa rekomandime nga FMN ja lidhur me implikimet buxhetore për skemat pensionale. Projektligji i cili ka ardhur nga qeveria ka qenë plotësisht i harmonizuar me FMN ne e plotësim ndryshimet të cilat jon bërë nga komisioni funksional është shtuar kostoja shtesë buxhetore. Komisioni funksional ka proceduar përsëri raportin dhe siq po shifet shumicën e rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk i ka marrë parasysh. Ajo qfarë është paraqitur në projektligj psarashihet të kompensohen minatorët e kompleksit Trepça dhe të punësuarve në miniera, kurse rekomandimi i komisionit funksional është që të përfitojnë të gjithë të punësuarit. Prandaj është mirë të sqarohemi sa a janë paguar të gjithë të punësuarit në miniera apo vetëm minatorët

Besim Beqaj sqaroj se projektligji i cili ka ardhur është i harmonizuar dhe i është bërë vlerësimi i kostos buxhetore. Mendoj se amendamentet të cilat kanë ardhur nga komisioni funksional e ngarkojnë atë shumë buxhetin dhe është e pamundshme kjo kosto të bartet. Vlerësimet për pagesën e pensioneve janë bërë për minatorët ku dihet numri, për të punësuarit tjerë në kompleksin Trepça dhe minierat tjera nuk ka mundësi të ndahen mjete buxhetore.

Sali Asllanaj unë mendoj që punëtorët administrativ qoftë edhe të kompleksit Trepça, të kenë status të veçantë, do duhej të kenë status të njëjtë. Mendoj që neni 1 pika 1.7 nuk do duhej të kalojë, do duhej të jap rekomandim të mos aprovohet sepse duhen obligime tepër të mëdha buxhetore që nuk mund të mbulojmë.

Latif Gashi nëse ne e kalojmë këtë projektligj kështu siq na ka ardhur ne luajmë edhe me ndjenja të minatorëve ngase nuk do të ketë mundësi të realizohet. Unë rekomandoj që të hiqet fjala te neni 3 të gjithë të punësuarit dhe të jetë minatorët e kompleksit Trepça që është shifra e saktë me planifikim të buxhetit. Poashtu kisha dashur të diskutoj një qështje shumë të rëndësishme që është viti i përfitimeve të pensioneve, është rekomanduar viti 2004, dhe unë mendoj që kjo duhet të vlejë deri në vitin 1999 e jo deri në vitin 2004.

Kryetarja ahijet dikush nga skema pensionale prej atyre që janë paguar deri tash në këtë ligj që e keni sjell?

Përfaqësues i Ministrisë disa prej këtyre amandamenteve kanë implikimeve buxhetore. Sa i përket amendamentit 1 që është fjala për minatorët e Trepçës, është e vetmja skem pensionale që nuk është menagjuar drejtpërdrejt Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, prandaj kemi kërkuar që këtë draftligj ta sjellin nën menagjim të kësaj Ministrie. Të gjitha skemat në këtë ligj vazhdojnë pagesën përve këtij që duhet ta ndryshojmë dhe të zhvillojmë të gjitha procedurat nga fillimi.

Naser Osmani unë mendoj që është dashur që të jetë më e thjeshtë, sepse ka të bëjë me një kategori të të punësuarve që edhe kur kanë punuar kanë qenë raste sociale, ky është qëllimi që një kategori të trajtohen si raste sociale, fjala është për minatorët. Ne duhet të insistojmë që të shkojë me amendamentet tona të cilat i kemi pasur dhe mos të marrim për bazë amendamentet e Komisionit funksional, me atë ku preket interesi buxhetor.

Besim Beqaj unë mendoj që shumë qartë e tha deputeti, një duhet të kemi parasysh se po flasim vetëm për minatorët, njerëzit që kanë qenë në zgafella të minierave të cilët përveq punës dhe angazhimit që kanë bërë kanë pasur edhe probleme shëndetësore etj. Nëse hyjmë të i trajtojmë me skema të tilla të gjithë njerëzit e administratave, fabrikave atëherë do të vije situata që njerëzit tjerë do të pyesin aspektet sociale, qfarë të bëjmë atyre që nuk kanë përfituar asnjëherë nga shteti, kanë qenë të papunë. Duhet të kemi kujdes, ne nuk duam të cenojmë të drejtën e askujt, ata të cilët e kanë merituar dhe e meritojnë janë minatorët, ndërsa punëtorët tjerë të administratës se si ministri nuk do ta përkrahim asnjë amendament i cili do të ketë kosto shtesë dhe iu jep përfitues të tjerë të cilët nuk kanë të drejtë.

Me shumicë votash u miratuan rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për heqjen amendamentit 1, 9, 10 dhe 11.

Hykmete Bajrami nëse 70% të kontributit paguesit i takon bashkëshortes atëherë unë jam kundër.

Xhevdet Neziraj këtu është një problem se me rastin e vdekjes me i marr 3 pensione menjëher.

Ministria e punës dua të sqarohemi lidhur me koston e shpenzimeve të varrimit , shpenzimet e varrimit nuk u jepen të gjithë të pensionuarve por është në bazë të rastit të vdekjes. .Shoqatat e pensionistëve dhe pensionistët e kanë pasur kërkesë permanente, prandaj po ju them që kjo kosto do të shkoj maksimum deri 1.400.000euro.

Besim Beqaj Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është sponzoruese e këtij ligji dhe të gjithë këto kalkulime kanë mundur ti bëjnë para se te dërgojnë me aprovu në qeveri. Rekomandoj komisionin si ministër i financave që ndryshimet që vinë nga Ministrinë pa pasur argument të fortë nga ministria sponsorizuese mos ti trajtojnë.

Kryetarja siq është shënuar nuk kemi të bëjmë me shpenzimet e varrimit sepse shpenzimet bëhen atë ditë që vdes personi dhe për këtë shumica e komunave kanë marrë vendime të veçanta që shpenzimet e varrimit. Prandaj kisha rekomanduar të mos miratohet amendamenti 19.

Me shumicë votash, një Kundër Albana Fetoshi) dy abstenime (Xhevdet Neziraj dhe Hykmete Bajrami), rekomandohet të hiqet amendamenti 19 dhe të mbetet teksti si në projektligj.

Kryetarja një qështje tjetër ka të bëjë me hyrjen në fuqi të nenit 11 dhe 12 që kemi rekomanduar të mbetet si në projektligj që është viti 2016, ndërsa komisionit funksional ka propozuar 2015 .Në versionin e parë Ministria e Mirëqenies ka thënë në vitin 2014 me hy në fuqi .Fondi Monetar Ndërkombëtar ka reaguar dhe ka thënë që nuk mundet me hy në fuqi ky nen me kto pika të ligjit për arseje se ministria nuk është në gjendje mi jep shifrat e sakta.

Me shumicë votash, dy kundër, ansjë Abstenim, rekomandohet të fshihet amendamenti 20 dhe të mbetet teksti si në projektligj.

Sali Asllanaj pa marr parasysh edhe implikimet financiar, kisha dashtë që statusin e pensionistëve tatimpagues për punëtorët e arsimit që kanë punuar në periudhën e viteve 1989 /99, të arsimit , shëndetsis kisha dashtë mi njoft dhe mendoj që është një dobësi e jona morale nëse këtë punë nuk e bëjmë .Do të duhet të gjejmë mundësi financiare dhe ministria me çdo kusht të bëjë planifikimin të ardhmen që tju njihet aj status per vitet 1989/99

Besim Beqaj në parim të gjithë pajtohem për këtë por , kjo është paraparë me një vendim të veçant para se të kemi një kosto të saktë nuk mund të japim një qëndrim dhe të ndërhyjmë në ligj pa e ditur koston dhe vlerësimin e koston financiare të cilin aj ligj ose aj vendim e ka.

Sali Asllanaj nuk jam i kënaqur nga kjo përgjigje për arseje se po bëjmë një shmangie të një përgjithësie që e kemi ndaj një kategorie të puntorve për të cilët jemi krenuar që e kanë mbajtur arsimin gjallë dhe mos të ndjemë përgjithësi për këtë punë është defekt i joni shumë i madh.

Kryetarja ka mbetur të nxjerret një ligj në të ardhmen , apo akte tjera ku ligji nuk mund të nxjerret pa u bërë një vlerësim buxhetor dhe nuk po shko ndonjë gjë që nuk mundet me kalu, le të kalon , kur të hartohet ligji le të llogaritet kostoja buxhetore.

Latif Gashi ,realisht ne kemi edhe kategori tjera si të burgosurit politik , veteranët e luftës , po ashtu i kemi edhe punëtorët e arsimit të cilët ndoshta si rezultat i mos identifikimit të tyre nga shoqatat dhe nxjerrjes e numrit të tyre të saktë tyre , edhe sot e katërmbëdhjet vite i kemi pa beneficione.Ne i kemi trajtuar pa identitet këto kategori edhe gjithsesi i kemi vlerësuar punorët e arsimit të cilët kanë punuar për dhjetë vite.

Kryetarja amandamenti gjashtë mbetet i komisionit funksional.

Hykmete Bajrami pse nuk e kemi në shqyrtim ne si komision për Buxhet dhe Financa marrveshjen për normalizim e mardhanjeve për projektligjin Kosovë – Serbi ka një kosto të madhe buxhetore .A keni ju kosto si Ministri e Financave për implementim të marrëveshjes dhe sa është kjo ?

Besim Beqaj të gjitha përgjigjjet do të merren në seancën , kur do të flitet për aprovimin e marrëveshje? Këto marrveshja janë politike të cilat kalojnë në Komisionin për Legjislacion i cili është komision funksional. Ju keni mundur me kërkim por komisioni për legjislacion e ka kaluar ndërsa për të gjitha implikimet ne jemi zotuar si buxhetë që të mund të akomodohen brenda kornizave buxhetore të cilat si rishikim të buxhetit ti merrni shpejt dhe do ti shihin të gjitha pozicionet e reja dhe lëvizjet mbrenda limiteve buxhetore të cilat janë parapar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxorri këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 1, 9, 10, 11, 19 dhe 20.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamentet 1, 9, 10, 11, 19 dhe 20 të komisionit funksional, të hiqen.
4. **Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2014/01;**

Kryetarja kërkesa buxhetore për rishikimin, ne si komision u dakorduar që ta shqyrtojm me shqyrtimin e buxhetit për vitin 2013 në mënyrë që të shohim se qka është përfshir dhe qka nuk është përfshir .Mirpo e kemi shqyrtimin e kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave, ne e kemi miratuar qarkoren e parë deri ku ka shku procesi me Ministrin e Financa nuk e di dhe e keni fjalën me na dhën sqarime.Kërkesa ka ardh për me dal në komision ne e kemi dhe ne e kemi pikë të rendit të ditës.

Ismet Krasniqi sipas ligjit për menaxhimin e financave publike i është adresuar komisionit për shqyrtim. Sa i përket shpenzimev edhe kodeve të parapara për vitin 2014 nuk kemi shmangje në përputhje me kërkesat tona , me përjashtim të një kërkesa buxhetore në shumë prej 134000 euro dhe është shumë që është parapar për mbulimin e një aktiviteti të sigurimit shëndetsor të deputetëve dhe administratës dhe stafit mbështetës politik.

Kryetarja është mirë me pas sigurimin shëndetsor por nuk e di nëse ndonjë institucionet publike a paguhet prej buxhetiti të Kosovës dhe nuk është mirë që ne si Kuvend ta bëjmë këtë sepse ashtu kështu jemi të diskutuar nga opinioni publik dhe me pas të gjitha institucionet janë të interesuar që të shkojnë në këtë formë siq ka shkuar Kuvendi.Këto qështje të cilat janë me të veqanta si ky rast është më mir të diskutohen në kryesi dhe me marr një vendim dhe ne jemi të obliguar mi zbatu rekomandimet që na vin nga kryesia.

Hykmete Bajrami ne si anëtar të Kuvendit dhe stafi i administratës besoj që qëndrojmë më mirë me paga dhe sigurimet shëndetsore mi pagu vet nga pagat tona dhe kur kompania e sigurimeve bënë ofertën për një institucion që përfshin numër më të madh ajo ofron edhe pako më të favorshme. Pajtohem që për këtë qështje të vendos Kryesia që mos të na mbetet neve faji për një vendim të till.

Ismet Krasniqi në radhë të parë kjo është një shumë e disponueshmërisë të mjeteve për me ushtruar aktivitetin, për shkak se ktu ka pas edhe tender publik, se ka diska kompani që ofrojnë sigurimet kjo shumë mundë të jetë më e vogël plus kjo shumë është e participimeve 50 përqind punoret dhe deputetet dhe 50 përqind Kuvendi. Mirëpo neve na duhet si një shumë pasqyra financiare për disponueshmëri të mjeteve me ushtruar aktivitetin në vitin 2014 dhe kjo shumë mund të jetë më e vogël kur ti shohim ofertat dhe të hapim tenderin.

Xhevdet Neziri pagat tona janë më të larta se të shërbësve tjerë dhe egziston një zë buxhetor ku bëhen pagesat ku mundesh me pagu edhe për pension suplementar ose Kuvendi me pas një buxhet më specifik sikurse e kanë shumë vende tjera.

Latif Gashi duke i pasur parasysh shumë probleme tjera si pensionet për punëtorët e arsimit, të burgosurit politik, veteranët e luftës në asnjë mënyrë vota ime nuk shkon pro për sigurime për deputet.

Kryetarja mbetet të diskutohet në Kryesinë e Kuvendit, nëse kryesia e merr një vendim të atillë siq e merr edhe për shumë qështje tjera ne mandej e shikojmë e bëjmë kërkesën.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisionit me një votë Kundër (Xhevdet Neziraj dhe të gjithë anëtarët tjerë të pranishëm Për, nxorri këtë

Rekomandim

- I. Të miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014 për tri programet, me përjashtim të kërkesës përmbledhje e kërkesave buxhetore të Kuvendit për vitin 2014, dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave që të njëjtat t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona